



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1533 Prot.

Durrës, më 2.10.2023

**VENDIM**  
Nr. 57, datë 2.10.2023

**PËR**

**"MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË KUOTAVE NË CIKLIN E PARË TË  
STUDIMEVE NË DEPARTAMENTIN E SHKENCAVE TEKNIKE MJEKËSORE, NË  
FAKULTETIN E STUDIMEVE PROFESIONALE, TË UNIVERSITETIT  
"ALEKSANDËR MOISIU", Durrës".**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", në ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", në Udhëzimin nr. 12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë, në Urdhërin e përbashkët RASH dhe QSHA nr. 10 datë 10.07.2023 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2023-2024", në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, në Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu", në shkresën e Fakultetit të Studimeve Profesionale nr. 170/1 datë 28.09.2023, Senati Akademik;

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rishpërndarjes së kuotave në ciklin e parë të studimeve në Departamentin e Shkencave Teknike Mjekësore, në Fakultetin e Studimeve Profesionale, të Universitetit "Aleksandër Moisiu", për kuotat e mbetur për shkak të mos aplikimit në kategori të ndryshme, si më poshtë:
  - Dega Infermieri e Përgjithshme: 12 kuota të mbetura (1 kuotë nga "Program i dytë studimi", 2 kuota nga "të Huaj", 2 kuota nga Statusi i "Jetimit", 2 kuota nga pakica "Rom dhe Egjiptiane", 5 kuota nga "Trojet"), të rishpërndahen, 10 kuota në "Shqiptarë brenda vendit" dhe 2 kuota në "transferim studimesh";

- Dega Mami: 7 kuota të mbetura (1 kuotë nga "Program i dytë studimi", 1 kuotë nga "të Huaj", 1 kuotë nga Statusi i "Jetimit", 1 kuotë nga pakica "Rom dhe Egjiptiane", 3 kuota nga "Trojet"), të rishpërndahen në "Shqiptarë brenda vendit";
- Dega Fizioterapi: 4 kuota të mbetura (1 kuotë nga "të Huaj", 1 kuotë nga Statusi i "Jetimit", 1 kuotë nga pakicat "Rom dhe Egjiptiane", 1 kuotë nga "Trojet"), të rishpërndahen në "Shqiptarë brenda vendit";
- Dega Ndhmës Dentist: 4 kuota të mbetura (1 kuotë nga Statusi i "Jetimit", 1 kuotë nga pakica "Rom dhe Egjiptiane", 2 kuota nga "Trojet"), të rishpërndahen në "Shqiptarë brenda vendit".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- ✓ Zv. Rektorët.
- ✓ Administratori i Universitetit
- ✓ Drejtuesit e Njësive Kryesore.
- ✓ Drejtuesit e Njësive Bazë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

*Prof. Dr. Ksenela SOTIROFSKI*

